

**STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“DD Projects” SHPK**

Sot më datë 26.01.2022, Tiranë, si themeluese me të dhënat e mëposhtme:

Unë, Znj. Dorela Dajti, qytetare shqiptare, lindur në Lushnjë, e datëlindjes 27.09.1978, rezidente në Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 033024664 dhe Nr. Personal H85927046K, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

dhe

Unë, Znj. Iris Dajti, qytetare shqiptare, lindur në Tiranë, e datëlindjes 20.02.2001, rezidente në Shqipëri, mbajtëse e letërnjoftimit me nr. 034006828 dhe Nr. Personal K15220056D, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar,

kemi vendosur të nënshkruajmë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

**KREU I
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA**

Neni 1 - Forma

- 1.1 Shoqëria “DD Projects” Shpk (në vijim “Shoqëria”), krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.
- 1.2 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3 Akti i themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionit shqiptar që ka karkater të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqiptar.

Neni 2 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është “DD Projects” Shpk

Neni 3–Objekti i shoqërisë:

- 3.1 Blerje dhe dhënie me qera e ndërtesave dhe apartamenteve,
- 3.2 Blerje, shitje, shkëmbim, valorizim, tregtim i tokave, apartamenteve dhe ndërtesave,
- 3.3 Konsulencë të fushave të ndryshme, përfshirë atë ligjore, komisione ndërmjetësimi si dhe analizë dhe preventiva, ndërtime, ristrukturime, shkatërrime, rindërtime dhe rekupeime ndërtimore të godinave, ndërtesave civile dhe industriale, rustike.


- 3.4 Analizë dhe preventiva, realizim, administrim dhe mirëmbajtje e veprave të vogla dhe të mëdha infrastrukturore. Analizë dhe preventiva, realizim i çdo lloj veprave dhe punë ndërtimi.
- 3.5 Marrje punimesh për ndërtim, shitje, shkëmbim, ristrukturim, marrje dhe dhënie me qera, administrim dhe menaxhim pasurish të patundshme në përgjithësi, në pronësi si publike ashtu edhe private.
- 3.6 Krijimi, blerja, administrimi si direkt ashtu edhe indirekt, i ndërmarrjeve që veprojnë në sektorët ekonomike të tregtisë, industrisë dhe të shërbimeve- të tretët në përgjithësi, përfshirë aktivitetet e ndërmjetësimit dhe me përjashtim të aktiviteteve të kreditimit dhe sidoqoftë të atyre aktiviteteve për ushtrimin e të cilave kërkohen autorizime specifike përveç kur këto nuk lëshohen.
- 3.7 Operacione me natyrë industriale, financiare (jo ndaj publikut) tregtare, mobiliare dhe imobiliare, përfshirë leasing (përfshihet aktiviteti i qerasë financiare) që organi 2 administrativ do të konsiderojë të nevojshme dhe të dobishme, edhe me ndihmën e rrjeteve telematike, si-edhe të japë garanci reale dhe personale edhe në favor të të tretëve.
- 3.8 Shoqëria mund të marrë kuota, në shoqëri të cdo lloji, në kufijtë të cilët nuk përbëjnë aktivitet mbizotërues të shoqërisë duke ju referuar ligjit dhe cdo normative tjetër në këtë fushë dhe jo ndaj publikut, për qëllimet e kolokimit dhe të aktivitetit të llojit fiduciar. Shoqëria mund të japë garanci, fidejushione, hipoteka dhe në përgjithësi garanci personale dhe reale, të lejojë transkriptime dhe shënime gjithshka në interes të të tretëve dhe për impenjime të të tjerëve, edhe në rast se garancia është për të gjithë ortakët ose për shoqëri.

Neni 4 - Selia

- 4.1 Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga "Haxhi Hysen Dalliu"191/1 , Njësia Administrative Nr. 09, Kodi postar1016, Tiranë.
- 4.2 Transferimi i Selisë së shoqërisë në një vend tjetër do të bëhet nga Vendimi i Asamblesë së Ortakëve.
- 4.3 Asambleja e Ortakëve do të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe zyrave përfaqësuese në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë vendit.

Neni 5 - Kohëzgjatja

- 5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është me afat të papërcaktuar.
- 5.2 Ndryshimi i afatit të kohëzgjatjes së veprimtarisë së shoqërisë do të bëhet nga Vendimi i Asamblesë së Ortakëve.



KREU II
KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I
KUOTAVE

Neni 6 - Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë i nënshkruar dhe i paguar përbëhet nga 2 (dy) kuota, me vlerë të përgjithshme 100 (njëqind) lekë, që përbën 100% të kapitalit themeltar.

Neni 7 - Kontributet

7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- **Znj. Dorela Dajti**, qytetare shqiptare, e cila ofron një kontribut në para të barabartë me 50 (pesëdhjetë) lekë.
- **Znj. Iris Dajti**, qytetare shqiptare, e cila ofron një kontribut në para të barabartë me 50 (pesëdhjetë) lekë.


7.2 Sipas kontributeve të mësipërme :

- **Znj. Dorela Dajti**, i përket 1(një) kuotë, që i korrespondon 50% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë, në vlerën respektivisht 50 (pesëdhjetë) lekë.
- **Znj. Iris Dajti**, i përket 1(një) kuotë, që i korrespondon 50% (njëqind përqind) të kapitalit të Shoqërisë, në vlerën respektivisht 50 (pesëdhjetë) lekë..

Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.



Neni 9 - Zvogëlimi i kapitalit themeltar

- 9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 10 - Transferimi i kuotave

- 10.1 Kuotat janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
- 10.2 Në rast transferimi në çdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor të subjekteve të tjerë të ndryshem nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftoj ortakët e tjerë, me leter rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar çmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruar për shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kanë hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e afuara nga ortaku që transferon kuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që ata zotërojnë, përveç rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht.
- 10.7 Kuotat mund të transferohen për shkak trashëgimie *mortis causa*.

KREU III

ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 11- Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.
- 11.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi, dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja

e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për çdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.

Neni 12 - E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës

- 12.1 Cdo ortak ka ta drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron.
- 12.2 Cdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

Neni 13 - Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në çdo moment nga një prej Administratorëve si dhe prej një ose disa ortakëve që parfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje me fax apo telegram që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve - dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 8 (tetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.3 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mblidhet me thirjen e parë për mungesën e kuoromit të parashikuar në pikën 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.
- 13.4 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohej atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin ku ndodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.5 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formalite të vetënjohimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.
- 13.6 Vendimet e Asamblesë së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 70% (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesë së Ortakëve që kërkojnë një shumicë të cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me

të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 70% (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar.

- 13.7 Asambleja e Ortakëve vendos me shumicë të cilësuar ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e ortakëve të pranishëm. Në të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakëve merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të ortakëve të pranishëm.
- 13.8 Cdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 13.9 Vendimet e Asamblesë duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesë dhe nga Sekretari.

Neni 14 – Administrimi

- 14.1.1 Shoqëria administrohet nga një administrator i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë 5 vjeçare (pesë).
- 14.1.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtrojë të gjitha fuqitë konform me saparashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar.
- 14.1.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posacëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.
- 14.1.4 Administratori nuk ka të drejtë të kryejë veprime në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe veprime të tjera me rëndësi thelbësore për shoqërine pa miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të përfaqësuar nga Ortakët.
- 14.1.5 Adminisitrator i parë i shoqërisë emërohet **Znj. Iris Dajti** qytetare shqiptare, lindur në Tiranë, e datëlindjes 20.02.2001, mbajtëse e letërnjoftimit me nr.034006828 dhe Nr. Personal **K15220056D**.

Neni 15- Eksperti kontabël i autorizuar

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.



KREU IV
VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligji n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 16.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të veçanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.


KREU V
SHPËRNDARJADHE LIKUJDIMI I SHOQERISË

Neni 18– Prishja

- 18.1 Shoqëria priset me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2 Shoqëria nuk priset në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likujdohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit, dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.
- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.



19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe atë që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejte ndërmjet palëve të interesuara.

20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, atëherë mosmarrëveshja e ortakëve do të zgjidhet nga gjykata me juridiksion përkatës.

Neni 21 –Gjuha

21.1 Ky Statut është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

* * *

ORTAKET E SHOQËRISË

Znj. Iris Dajti

Iris Dajti



Iris Dajti



Znj. Dorela Dajti

